

AKT THEMELIMI
I Shoqerise Tregtare "Landeslease" SH.A.

Anetaret per themelimin e Shoqerise tregtare "Landeslease" SH.A. mbledhur me 22/3/2005 sipas Ligjit "Per shoqerite tregtare" N. 7638 te dt. 19.11.1992 dhe sipas Ligjit "Mbi regjistrimin e shoqerive tregtare" N.7667 te dt.29.011.1993, vendosen themelimin e shoqerise "Landeslease" SH.A.

Ortakët themelues të shoqerise jane personat juridik si me poshte:

1. Zoti Basri Rruka i biri i Faredinet, dtl.1951, lindur ne Kukes dhe banues ne Rr."Puntoret e Rilendjes", pall.3 ne Tirane i paisur me pasaporte me nr.Z0538742.
2. Zoti Stephen Strauss, banues ne Illinois Amerike me nr. 710297645 pasaporte.
3. Hysen Ruka i biri i Faredinit, dtl. 1960 dhe banues ne Tirane, Rr."Ismail Qemali", pall.1 bardhe, i paisur me pasaporte me Nr.Z0147502;

te cilet bien dakort per sa vijon.

NENI 1

Themelimin e nje shoqerie anonime duke u bazuar ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut dhe duke respektuar ate cfare kerkon legjislacioni shqiptar.

NENI 2

Emertimi i shoqerise do te jete "Landeslease" SH.A.

NENI 3

Objekti i Shoqërisë do të jetë:

- Dhënie me qera dhe financime të ndryshme të të gjitha mallrave e paisjeve pa kufizim
- Blerje, shitje dhe shkëmbime të mallrave e paisjeve si më sipër
- Ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm i cili do të aprovohet nga ortakët

NENI 4

Vendi i zhvillimit të aktivitetit është territori i Shqipërisë, selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë Rr."Brigada e Tete" pall."Teknoprojekt", kati 3.

Me vendim të Këshillit Mbikqyrës, mund të hapen filiale, zyra, dhe shërbime në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë.

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur për 20 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në gjykatë. Shoqëria mund të shpërbëhet edhe para skadencës së 20 - vjetëve ose mund të zgjasë afatin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme, sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 6 KAPITALI

Kapitali shoqëror fillestar është vendosur 2 000.000. (dy milion) Lek.

NENI 7

Kapitali është formuar nga themeluesit e saj qe :

- | | |
|----------------------------|---------------------|
| 1. Zoti Basri Rruka me | 16.6 % te kapitalit |
| 2. Zoti Stephen Strauss me | 16.6 % te kapitalit |
| 3. Zoti Hysen Ruka me | 66.8 % te kapitalit |

NENI 8

Kjo kontrate eshte formuluar ne kater kopje, pasi eshte firmosur me vullnetin e lire dhe te plote te themeluesve para Noterit. Nje kopje depozitohet prane zyres se Noterise Tiranes, Gjykatën e Shkalles se pare Tirane, nje kopje prane organeve te Tatimeve dhe Taksave dhe nje kopje depozitohet prane shoqerise.

ORTAKET THEMELUES

Basri Rruka

Stephen Strauss

Hysen Ruka

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterise Tiranë

Notere Mimoza Shehu

Nr. 3076 Repertorit

Nr. 912 Koleksionit

VËRTETIM

Sot me Dt. 27/3 / 2005 (dymijë e pese) në Zyrën e Noterisë Tiranë para meje Mimoza Shehu u paraqitën personalisht 1. Zoti Basri Rruka; 2. Zoti Stephen Strauss dhe 3. Zoti Hysen Ruka, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar të cilet deklaruan se sa sipër është redaktuar sipas vullnetit të tyre, nenshkruan aktin në praninë time dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Mimoza Shehu
Notere
Mimoza Shehu
(06) 432 453, (06) 227 123

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE "LANDESLEASE" S.H.A.

Anetaret për themelimin e Shoqërisë tregtare "Landeslease" S.H.A. mbledhur me 27/3 / 2005 sipas Ligjit "Për shoqëritë tregtare" N. 7638 të dt. 19.11.1992 dhe sipas Ligjit "Mbi regjistrimin e shoqërive tregtare" N. 7667 të dt. 29.01.1993, vendosën themelimin e shoqërisë "Landeslease" S.H.A.

KAPITULLI I PARE

Themelimi – Forma – Kohëzgjatja – Emërtimi – Objekti – Kapitali themelor

NENI 1

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Zoti Basri Rruka i biri i Faredinet, dtl. 1951, lindur në Kukës dhe banues në Rr. "Puntoret e Rilindjes", pall. 3 në Tiranë i paisur me pasaportë me nr. Z0538742.
2. Zoti Stephen Strauss, banues në Illinois Amerikë me nr. 710297645 pasaportë.
3. Hysen Ruka i biri i Faredinit, dtl. 1960 dhe banues në Tiranë, Rr. "Ismail Qemali", pall. 1 bardhe, i paisur me pasaportë me Nr. Z0147502;

NENI 2

Vendi i zhvillimit të aktivitetit është territori i Shqipërisë, selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresë Rr. "Brigada e Tete", pall. "Teknoprojekt", kati 3. Me vendim të Këshillit Mbikqyres Asamblese Përgjithshme, mund të hapen filiale, zyra, dhe shërbime në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë.

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur për 20 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në gjykatë. Shoqëria mund të shpërbëhet edhe para skadencës së 20-vjeleve ose mund të zgjasë afatin me vendim të Asamblese së përgjithshme të jashtëzakonshme, sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 4

Objekti i Shoqërisë do të jetë:

- Dënie me qera dhe financime të ndryshme të të gjitha mallrave e paisjeve pa kufizim
- Blerje, shitje dhe shkëmbime të mallrave e paisjeve si më sipër
- Ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm i cili do të aprovohet nga ortakët

KAPITULLI II

Kapitali fillestar – Aksionet

NENI 5

Kapitali fillestar është vendosur 2 000.000 (dymijlion) Lek
Kapitali është kontribut i themeluesve në masen:

- | | |
|----------------------------|---------------------|
| 1. Zoti Basri Rruka me | 16.6 % te kapitalit |
| 2. Zoti Stephen Strauss me | 16.6 % te kapitalit |
| 3. Zoti Hysen Ruka me | 66.8 % te kapitalit |

NENI 6

Ndryshimi i kapitalit shoqëror.

Rritja e kapitalit shoqëror.

Kapitali shoqëror rritet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe ndryshimi i statutit shoqëror në bazë të raportit të drejtimit.

Kapitali bazë, rritet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kapitalit egzistues.

Aksionet e reja paguhen me para ose nëpërmjet shlyerjes në natyrë. Në rastin e rritjes së kapitalit nëpërmjet shlyerjes në natyrë, me vendim të gjykatës emërohen një ose disa ekspertë që përcaktojnë vlerën e shlyerjes në natyrë, sipas nenit 162 dhe kufizimeve të neneve 168, 169 të Ligjit 7638/92.

NENI 7

Zvoglimi i kapitalit fillestar.

Zvoglimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja e jashtëzakonshme.

Në Asamblesë e thirrur për zvoglimin e kapitalit dorëzohet referimi i argumentuar i Drejtuesve duke shpjeguar motivet që e detyrojnë për të marrë këtë vendim. Në të gjitha rastet zvoglimi i takon aksionerëve në të njëjtën masë, në mënyrë proporcionale me vlerën e aksionit që ato zotërojnë, sipas Nenit 164 të Ligjit 7638/92.

Projekti i zvoglimes duhet të komunikohet ekspertëve kontrollorë të paktën 45 ditë para se Asambleja të mbledhet për të vendosur për projektin.

NENI 8

Derdhja dhe verifikimi i kapitalit

Nuk mund të merret vendim për rritjen e kapitalit aksioner nëse ai nuk është derdhur tashmë tërësisht. Në rast të kundërt veprimi i rritjes së kapitalit dhe i emetimit të aksioneve të reja konsiderohet i pavlefshëm, sipas Nenit 153 të Ligjit 7638/92. Këshilli Mbikqyrës në rast rritje të kapitalit duhet që brenda një afati 3 – muor nga rritja e kapitalit të verifikojë vërtetësinë e kapitalit.

Nëse kapitali nuk është mbuluar tërësisht atëherë Këshilli Mbikqyrës do të vendosë lirshëm për aksionet e pambuluara e mund të japë edhe të tretëve, deri në shumën e nevojshme për mbulimin e plotë.

KAPITULLI I III

Aksionet

NENI 9

Aksionet janë nominative. Për aksionet do të leshohen titullare transferimesh sipas ligjit, lloji I të cilave do të vendoset nga Këshilli Mbikqyrës që do të tregojë njëzërit që do të firmosin aksionet nominative. Aksionet nominative u transferohen të treteve sipas nenit 198 të ligjit 7638/92. Në castin e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj mund të krijohen aksione të privileguara me avantazhe në krahasim me aksionet e tjera, sipas nenit 148 dhe 149 të ligjit 7638/92.

NENI 10

Aksionet janë të pandashme karshi shoqërisë e cila njih vetëm një pronar kryesor të aksioneve. Çdo aksion të jep të drejtën e një vote. Kur për një ose me shumë aksione ka me shumë se një pronar, atëherë të drejtat duhet të ushtrohen nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, por nëse nuk kanë emëruar përfaqësues, ushtrimi i të drejtave mbetet pezull.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga cdo aksion, ushtrohen nga mbajtési i tyre i ligjshem.
Aksioneri ushtrohet te drejtat e tije persa i perket Drejtimit te shoqerise nepermjet Asamblese se Pergjithshme .

NENI 11

Nese aksioneri do te transferoje nje pjese ose te gjitha aksionet duhet te njoftoje me shkrim Keshillin Mbiqyres mbi vleren e aksioneve ne menyre qe te ushtrohet e drejta e parablerjes per te blere aksionet ne fjale. Keshilli eshte i detyruar qe brenda 10 ditesh nga shenimi, te bej njoftimin.
Cdo transferim aksionesh i kryer ne kundërshtim me kete nen eshte i pavlefshem dhe nuk ka efekte te ligjshme.

KAPITULLI IV-te

Organet e shoqerise

NENI 12

Keshilli Mbiqyres

Pergjegjesia e drejtimit te shoqerise i perket Keshillit Mbiqyres qe zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme qe perbehet nga tre anetare, jo me pak se tre dhe jo me shume se nente , ne menyre qe mund te ndahen ne tre. Keshilli i pare Mbiqyres qe do te drejtoje shoqerine perbehet nga

1.Hysen Ruka
Kryetar

2.Fatos Lulo
Zv/kryetar

3.Basri Rruka
Antar

NENI 13

Asambleja e Pergjithshme mund te zgjedhe si antar te keshillit mbiqyres edhe individe , te cilet nuk jane aksioner. Antaret e Keshillit Mbiqyres nuk kane pergjegjesi personale kundrejt te treteve dhe kundrejt aksionereve te shoqerise.Por kane pergjegjesi kundrejt personit juridik te shoqerise per detyrat qe u jane ngarkuar:Keshilli Mbiqyres zgjedh kryetarin dhe nenkryetarin;kryetari kryeson mbledhjen dhe ne mungese te tij zevendesohet nga nje nenkryetar.

NENI 14

Kohezgjatja e mandatit te antareve te keshillit Mbiqyres caktohet per nje periudhe gjashte vjecare e cila shtyhet deri ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme qe do te

  

miratoj tabelat financiare (rezultatet) vitit financiar qe u mbyll dhe Asambleja e pergjithshme do te mblidhet detyrimisht brenda gjashte mujorit te pare nga mbyllja e vitit financiar. Ne rast vdekje, shkarkimi nga detyra ose te mungeses te pajustifikuar te nje antari te keshillit Mbiqyres nga mbledhja per tre muaj rresht. Keshilli Mbiqyres mund te zgjedhe zevendes deri ne mbledhjen e pare te Asamblese se pergjithshme.

Keshilli Mbiqyres thirret nga mbledhja tre here ne muaj. Keshilli mund te zgjedhe zevendes te tij deri ne mbledhjen e pare te asamblese se pergjithshme. Keshilli Mbiqyres thirret nga kryetari dhe ne rast se ai nuk ka mundesi ose mungon thirret nga nenkryetari ose ne raste te jashtezakonshme mbas kerkeses te pakten te dy antareve dhe vendimet merren me shumice votash te te pranishmeve dhe te votave te perfaqesuar. Keshilli Mbiqyres ka qourum dhe mblidhet ligjerisht kur jane prezent ose perfaqesohen te pakten gjysma plus nje e numurit te antareve te tij. Antari i Keshillit Mbiqyres qe mungon mund te perfaqesohet ne mbledhjen e keshillit Mbiqyres vetem nga nje antar Keshilli Mbiqyres.

NENI 15

Per diskutimet qe behen dhe vendimet qe merren, mbahet proces verbal i cili nenshkruhet nga antaret prezent, ne proces verbal shenohen edhe mendimet e atyre qe nuk jane dakort.

Keshilli Mbiqyres ushtron kontroll ndaj Drejtorit per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Ai ka te drejte te kryej ne cdo kohe verifikimet dhe kontrollat qe ai i çmon te arsyeshme dhe te kerkoje ne cdo kohe te njihet me dokumentat qe ai gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij. Keshilli Mbiqyres nuk ka te drejte te marre vendime per ceshtje qe jane ne kompetencat e Asamblese se Pergjithshme. Tek antaret e keshillit mbiqyres jepet shperblim i cili percaktohet me vendim te asamblese se pergjithshme.

Ne shoqerine "Landeslease" sh.a Drejtor eshte: z.Stephen Strauss.

NENI 16

Drejtori perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet dhe eshte kompetente te vendose per cdo ceshtje qe ka te bej me drejtimin e saj, administrimin e pasurise se saj dhe ne pergjithesi ne arritjen e qellimeve te saj brenda objektit te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ju a jep shprehimisht keshillit mbiqyres dhe asamblese se aksionereve. Drejtori i paraqet raport keshillit mbiqyres te pakten nje here ne tre muaj.

  

NENI 17

KONTROLI I SHOQERISE

Ne shoqerite anonime kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar. Ekspertet kontabel te autorizuar emrohen nga asamblea e zakonshme ne mbledhjen e saj me perjashtim te ekspertit te pare te percaktuar ne status djhe kane mandat nje vjecar. Ekspert i pare kontabel eshte z. _____

Asamblea e pergjithsme do te emroj nje ekspert kontabel te autorizuar i cili ka keto veti.

Ndihmon ne mbajtjen e llogarive te shoqerise ne menyre qe ato te jene sipas parimeve baze te kontabilitetit.

Pergatit raportin vjetor te te dhenave ekonomike (bilancin) llogaria e fitimeve dhe humbjeve si dhe te dokumentave te tjera qe kane lidhje me to) dhe shpreh mendimin nese te dhenat ekonomike reflektojne realitetin e gjendjes ekonomike te shoqerise. Informon keshillin mbikqyres ne lidhje me ndonje paregullsi te mundeshme qe vijhet re ne shkembimet procedurat, aktivitet ose llogarite e shoqerise te cilat do te mund te cojne ne ekzistencen e humbjeve per shoqerine. Ekspertet kontabel te autorizuar sigurohen qe eshte respektuar barazia midis aksionereve.

NENI 18

Ne rast te moskryerjes me saktesi te deyrave te tij ekspereti kontabel i autorizuar mund te pezullohet nga detyra e tij me vendim gjyqi i cili mblidhet dhe vendos me procedure urgjente.

NENI 19

Eksperti kontabel i autorizuar ka per detyre te mbikqyr llogarite vjetore te cilat duhet te jene te perpilura ne baze te rregullave nderkomebtare te pranura dhe te shprehi me saktesi rezultatet e periudhes ushtrimore si dhe te jape me sinqeritet dhe rezultatin e dale ne fund te vitit financiar. Eksperti kontabel ka dhe kompetenca qe percaktohen nga nent 178, 179, 180 dhe 182 te Ligjit 7638 /92.

Eksperti kontabel ka mundesi mbas kerkeses se tij te ndihmohet ne veprimtarine e tij nga eksperte te cilet do te empojen nga keshilli mbikqyres ne baze te nenit 19 te ligjit 7560/92.

NENI 20

Ekspertet kontabel te autorizuar u bejne te njohur drejtorise dhe keshillit mbikqyres:

1. kontrollat dhe verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet e ndryshme qe kane bere.

2. Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ne te cilat sipas tyre duhet te ishin bere ndryshime, duke bere gjithashtu edhe te gjitha verejtjetet e duhura mbi metodat e vleresimit te perdorura ne perpilimin e ketyre dokumentave.
3. Parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.
4. Perfundimet qe rrjedhin nga verejtjet dhe korigjimet e mesiperme mbi rezultatet e vitit financiar te meparshme.

NENI 21

Per ndermarrjen e veprimeve dhe per derdhjen e shperblimeve te antareve te keshillit mbikqyres te drejtuesit dhe te ekspertit kontabel, zbatohen nenet 122, 127 te ligjit 7638/92.

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem ose nga Keshilli Mbikqyres i perbere nga tre deri ne pese anetare te zgjedhur nga Asamblea e zakonshme qe i emerohet, te zgjedhur edhe ndermjet ortakeve. Emerohen ne fillim ne Aktin e themelimit e ne vijim nga Asamblea dhe e mbajne kete detyre gjate periudhes se funksionimit te shoqerise.

NENI 22

Firma dhe perfaqesimi shoqeror perballe te treteve, i perkasin Keshillit Mbikqyres ose Drejtori te emeruar dhe me kufizimet e delegimit, Administratoreve te deleguar.

NENI 23

Vendimet.

Keshilli Mbikqyres vendos me voten e favorshme te mazhorances se anetareve te emeruar. Vota e kundert e nje ose me shume Keshilltareve do te nderprese vendimmarrjen per pesembedhete dite.

NENI 24

Kompensimi.

Kompesimi per organin administrativ, edhe me pjesmarrje ne fitimin shoqeror, vec rimbursimit te shpenzimeve te kryera per zyren, percaktohet nga Asamblea e zakonshme.

NENI 25

Drejtori teknik.

Organi administrativ mund te emeroje nje Drejtor tekniko – administrativ duke e zgjedhur edhe jashte shoqerise e duke percaktuar detyrat, perfaqesite dhe kompensimet.

KAPITULLI V

NENI 26

Aksioneri ka te drejte te informohet mbi aksionet, mbi Anetaret e Keshillit Mbikqyres te shoqerise 15 dite para mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

NENI 27

Ne rast refuzimi te pjesshem ose te plote nga ana e shoqerise per te informuar sa edhe ne nenin me siper, aksioneri qe mendon se te drejtat e tij jane shkelur ka te drejte te paraqese nje kerkese ne gjykate.

NENI 28

Aksioneret qe perfaqesojne nje te dhjeten e kapitalit kane mundesine te therrasin Asamblene e jashtezakonshme, duke caktuar rendin e dites. Keshilli Mbikqyres eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme te kerkuar, perjashto rastet kur kemi te bejme me nje motiv te rendesishem.

Aksioneret qe perbejne nje te dhjeten e kapitalit aksionar mund ti drejtohen Gjykates e te kerkojne kontrollin e pranise se motiveve te rendesishme per te thirrur Asamblene me nje vendim te Gjykates.

Me kerkese te Aksionereve qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit aksionar, Drejtori ka mundesine te anulloje vetem nje here vendimet e Asamblese se Pergjithshme te zakonshme ose te Jashtezakonshme, duke caktuar edhe ditën e mbledhjes per te marre vendime, jo me vone se 30 dite nga data e anulimit te vendimit te pare.

KAPITULLI VI

NENI 29

Shoqeria mban ne zyrat e saj librat e kerkuara nga ligji, ku jane llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, raportet ekonomike vjetore ku duhen shenuar cfare

parashikon ligji. Librat zyrtare te shoqerise, tabelat, bilancet dhe raportet vjetore duhet te mbahen ne gjuhen shqipe.

NENI 30

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh duke filluar nga nje Janari deri me 31 dhjetor te cdo viti, ben perjashtim viti i pare qe fillon nga data e regjistrimit ne Gjykate dhe perfundon me 31.12.2005. Ne perfundim te cdo viti financiar Keshilli Mbikqyres ben regjistrimin e inventarit dhe llogarite vjetore sipas dispozitave ligjore ne fuqi mbi kontabilitetin dhe relacionin mbi administratimin.

NENI 31

Krijohet nje kapital rezerve i domosdoshem me te pakten 5% te fitimeve, pasi zbriten humbjet e mundshme te pesuara ne vitet paraardhese.

Kjo procedure perfundon se qeni e detyrueshme kur nje rezerve e tille arrin 1/10 e kapitalit shoqeror.

NENI 32

Fitimet qe do te ndahen perbejne fitimet e vitit financiar pasi te hiqen rezervat dhe humbjet e mundshme te viteve paraardhese, sipas nenit te mesiperm.

NENI 33

Emertimi dhe dividendet

Pas aprovimit te bilancit dhe regjistrimit te shumes qe do te ndahet, Asamblea e Pergjithshme percakton shumen qe do te ndahet per aksionet si dividend, sipas neneve 215, 261 dhe ligjit 7638/92 (sipas kapitalit aksionar).

NENI 34

Aksioneri ka te drejte te informohet mbi aksionet, mbi anetaret e Keshillit Mbikqyres te shoqerise 15 (pesembedhete) dite para mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

NENI 35

Ne rast refuzimi te pjesshem ose te pergjithshem nga ana e shoqerise per informim sipas nenit paraardhes, aksioneri qe mendon se te drejtat e tij jane dhenuar ka te drejte te paraqese nje kerkese ne Gjykate.

NENI 36

Aksioneret qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit kane mundesi te therrasin Asamblene e jashtezakonshme , duke caktuar edhe rendin e dites . Keshilli Mbikeqyres eshte i detyruar qe te therrase Asamblene e Pergjithshme perjashto rastet qe te jete nje motiv i rendesishem .

Aksioneret qe perbejne 1/10 e kapitalit aksionar mund ti drejtohen Gjykatës per te kerkuar kontrollin e ekzistences se motiveve te rendesishme dhe te therrase Asamblene me nje vendim te Gjykatës.

Me kerkese te aksionereve qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit aksionar, Drejtori ka mundesine te anulloje vetem nje here vendimet e Asamblese se Pergjithshme te zakonshme e te jashtezakonshme, duke caktuar edhe ditën e mbledhjes per te marre vendime, kjo dite nuk mund te jete me larg se tridhjetë dite nga data e anulimit te vendimit te pare.

KAPITULLI VII-te

NENI 37

Shoqeria mban prane zyrtare te saj librat e kerkuara nga ligji, ku jane llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, raportet ekonomike vjetore ku duhen shenuar faktet e parashikuara nga ligji. Librat zyrtar te shoqerise, tabelat, bilancet dhe raportet vjetore duhen mbajtur ne gjuhen shqipe.

NENI 38

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjetë muajsh, duke filluar nga nje Janari deri me 31 dhjetor te cdo viti, ben perjashtim viti i pare qe fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Gjykatë dhe perfundon me 31. 12. 2005.

Ne perfundim te cdo viti financiar Keshilli Mbikeqyres ben regjistrimin e inventarit dhe llogarite vjetore sipas depozitave ligjore ne fuqi mbi kontabilitetin si dhe relacionin mbi administrimin.

NENI 39

Krijohet nje kapital rezerve i domosdoshem i cili krijohet nga te pakten 5% te fitimet, pasi zbriten humbjet e mundshme qe ke pasur ne vitin paraardhes. Kjo procedure perfundon se qeni e domosdoshme kur kjo rrezerve arrin 1/10 kapitalit shoqeror.

NENI 40

Fitimet qe do te ndahen perbejne fitimet e vitit financiar pasi te zbriten rezervat dhe humbjet e mundshme te vitit paraardhes, sipas nenit te mesiperm.

NENI 41

Percaktimi i dividendeve.

Pas aprovimit te bilancit dhe regjistrimit te shumes qe do te ndahet, Asamblea e pergjithshme percakton shumen qe do te ndahet ndermjet aksioneve si dividend, sipas nenit 215, 261, te ligjit 7638/92 (sipas kapitalit aksioner).

KAPITULLI VIII-te

NENI 42

ZGJIDHJA

Shoqeria zgjidhet kur skadon kohezgjatja e saj ose nese ka deklaruar falimentim.

NENI 43

LIKUIDIMI

Likuidimi i shoqerise behet sipas depozitave ligjore.

Shoqeria kryen likuidimin nga casti i zgjidhjes se saj nga cdolloj arsye, me perjashtim te rastit te parashikuar ne nenin 10 te ligjit 7638/92 .Gjate likuidimit emertimi i shoqerise perfshin shprehjen "ne likuidim".

Kjo shtese si dhe emri i likuiduesit duhet te tregohen ne te gjitha aksionet e dokumentat e leshuara nga shoqeria.

KAPITULLI IX-te

NENI 44

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Per ceshtje te paparashikuara ne statut dhe gjate themelimit te shoqerise do te aplikohen dispozitat ne fuqi per shoqerite anonime pa oferte publike.

KAPITULLI X-te

NENI 45

DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Mbulimi i kapitalit aksionar

Kapitali aksionar mbulohet nga ortakët themelues që janë:

- | | |
|----------------------------|---------------------|
| 1. Zoti Basri Rruka me | 16.6 % te kapitalit |
| 2. Zoti Stephen Strauss me | 16.6 % te kapitalit |
| 3. Zoti Hysen Ruka me | 66.8 % te kapitalit |

NENI 46

Emërtimi i shoqërisë është përcaktuar "Landeslease" SH.A dhe gjendet edhe me vullnetin e saj sipas nenit 57 të ligjit 7560/92.

NENI 47

Ky statut është përpiluar në pesë kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua u nënshkruhet nga aksionerët themelues.

NENI 48

Kjo shoqëri do të fillojë të funksionojë pasi të marri lejen nga Autoritetet përkatëse shqiptare, sipas legjisllacionit në fuqi dhe vetëm me këtë kusht.

AKSIONERE THEMELUES

Basri Rruka

Stephen Strauss

Hysen Ruka

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë Tiranë

Notere Mimoza Shehu

Nr. 803/ Repertorit

Nr. 813 Koleksionit

Takim i Partisë
u pagua

VËRTETIM

Sot me Dt. 27/3/2005 (dymijë e pese) në Zyrën e Noterisë Tiranë para meje Mimoza Shehu u paraqitën personalisht 1. Zoti Basri Rruka; 2. Zoti Stephen Strauss dhe 3. Zoti Hysen Ruka, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar të cilet deklaruan se sa sipër është redaktuar sipas vullnetit të tyre, nënshkruan aktin në praninë time dhe une noterja legalizoj nënshkrimet sipas ligjit

Notere
Mimoza Shehu
Tel: (04) 232 453, (04) 227 111

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. 33 304 Vendimi

VENDIM

(Per regjistrimin si person juridik)

Ne Tirane, sot me daten 05/10/2005 une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane M. Ruzha, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit: Hysen Ruka, Stephen Strauss dhe Basri Ruka, ne cilesine e aksionereve, per regjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Landeslease".

Nga meterialet e paraqitura nga kerkuesit:

KONSTATOVA:

Ne baze te dokumenteve te paraqitura del se zoterinjte Hysen Ruka, Stephen Strauss dhe Basri Ruka kerkojne te krijojne shoqerine "Landeslease" SH.A..

Kjo shoqeri e ka seline e saj ne Rr."Brigada e Tete", pall."Teknoprojekt" kati 3, Tirane.

Aksionere te kesaj shoqerie do te jene zoti Hysen Ruka, zoti Stephen Strauss dhe zoti Basri Ruka.

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2 000 000 (dy milion leke), i cili do te zoterohet nga aksioneret themelues te shoqerise anonime "Landeslease" SH.A.

z.Hysen Ruka ne masen 66.8 %, z.Stephen Strauss 16.6 % dhe z.Basri Ruka 16.6 %.

Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete 20 vjet.

Shoqeria "Landeslease"SH.A. do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

- Dhënie me qera dhe financime të ndryshme të të gjitha mallrave e paisjeve pa kufizim
- Blerje, shitje dhe shkëmbime të mallrave e paisjeve si më sipër
- Ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm i cili do të aprovohet nga ortakët

Meqenese kerkesa e kerkuesve eshte ne perputhje te plote me kerkesat e ligjit ajo duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Sipas ligjit nr.7638 te dates 19.11.1992 dhe ligjit nr.7667 te dates 28.01.1993